



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 200 Prot.

Tiranë, më datë 13.03.2025

VENDIM
Nr. 183, datë 13.03.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.03.2025:

VENDOSI

1. Mosmiratimin e kërkesës për vijimin e procedurës së legalizimit për objektin “Ndërtesë 1 katëshe me bodrum”, ndodhur në Zonën e Mbrojtur të Qendrës Historike të qytetit të Beratit, me subjekt aplikues **Znj. Shqiponja Pema, me argumentin;**
 - Kërkesa bien ndesh me Nenin 11 të Vendimit Nr. 170, datë 02.06.1961 “Mbi aprovimin e rregullores mbi administrimin e Qytetit-Muze të Beratit dhe me VKM nr. 827, datë 28.12.2023 “Për deklarin si pasuri kulturore e paluajtshme “Qendër Historike” të një zone në Qytetin-Muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

